



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 510/ Prot.

Durrës, më 07.02.2025

VENDIM

Nr 06, datë 07.02.2025

**“PËR MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË NUMRIT TË STUDENTËVE
CIKLIT TË PARË ME KOHË TË PLOTË, QË PËRJASHTOHEN NË MASËN 100% NGA
TARIFA E SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2024 – 2025”**

Në mbështetje të nenit 4 “e drejta e studimit”, nenit 49 “Funksionet e bordit të Administrimit”, nenit 98 “të drejtat dhe detyrimet e studentëve” të ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të neneve 1 dhe 5, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të neneve 2 dhe 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të neneve 1 dhe 15, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, dhe të neneve 5 dhe 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, VKM nr.698, datë 21.11.2018 Për një shtesë në Vendimin nr. 269, datë 29.3.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve profesionale që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, VKM nr.779, datë 26.12.2018 “ Për disa ndryshime në Vendimin nr. 269, datë 29.3.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” të ndryshuar, shkresave të Fakulteteve, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Përjashtimin në masën 100%, nga tarifa vjetore e shkollimit, studentët të cilët vijojnë studimet në ciklit e parë me kohë të plotë për vitin akademik 2024-2025 pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, të cilët vijnë nga shtresa sociale si kategori në nevojë, 187 studentë, efekti financiar 4,675,000 lekë, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:
 - Administratori
 - Drejtorja e Administrimit Financiar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

